

VENDIM
Nr. 265, datë 10.4.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 17, DATË 16.1.2019, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E SHOQËRIVE TË TJERA
SHTETËRORE OSE PRIVATE, TË RËNDËSISHME PËR INTERESIN E
PUBLIKUT, PËR SHKAK TË NATYRËS SË BIZNESIT, MADHËSISË OSE
NUMRIT TË PUNËMARRËSVE TË TYRE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç”, të pikës 23, të nenit 2, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në nënndarjen III, “Klasifikimi për shkak të madhësisë së biznesit”, të vendimit nr. 17, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a”, togfjalëshi “... 2 500 000 000 (dy miliardë e pesëqind milionë) lekë ...” zëvendësohet me “... 4 000 000 000 (katër miliardë) lekë ...”.

2. Në shkronjën “b”, togfjalëshi “... 1 250 000 000 (një miliard e dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë ...” zëvendësohet me “... 2 000 000 000 (dy miliardë) lekë ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama